

Në bazë të nenit 34, të Statutit të Akademisë Tempulli dhe nenit 3, paragrafi 1.9 të rregullorës së punës së Këshillit Akademik në mbledhjen e mbajtur më 10.10.2023 Këshilli Akademik miratoj këtë:

RREGULLORE PËR STUDIME MASTER NË AKADEMI

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me Rregullore të studimeve Master (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore”) në Akademinë Tempulli (në tekstin e mëtejshëm Akademia) përcaktohen dhe rregullohen çështjet si në vijim:

1. Llojet e studimeve
2. Organizimi i mësimit
3. Kushtet e regjistrimit në studime master
4. Kushti i regjistrimit të vitit
5. Statuti i studentit
6. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve
7. Afatet, paraqitja dhe përfundimi i provimeve
8. Përfundimi i studimeve dhe punimi i diplomës
9. Plagjiatura dhe e drejta intelektuale
10. Procedura e mbrojtjes së temës së masterit
11. Dispozitat kalimtare.

II. Llojet e studimeve

Neni 2

Me qëllim të përgatitjes së kuadrit shkencore dhe profesional në Akademi, në bazë të programeve të akredituara, mund të organizojë dy lloje të studimeve:

- Studime diplomike shkencore;
- Studime diplomike profesionale.

Niveli i kualifikimit përcaktohet në bazë të Kornizës Nacionale të Kualifikimeve të Republikës së Kosovës. Studimet diplomike shkencore/profesionale në ciklin e dytë të studimeve zgjasin katër semestra dhe me përfundimin e tyre studenti i grumbullon 120 ECTS kredi.

Titulli që fitohet është i/e diplomuar (Master) në fushën përkatëse në përputhje me Ligjin për arsim të lartë

Neni 3

Me studimet Master udhëheq Këshilli Akademik (në tekstin e mëposhtëm “Këshilli”)

Përbërja e Këshillit është e rregulluar me statutin e Akademisë.

III. Organizimi i mësimit

Neni 4

Studimet master sipas programeve përkatëse organizohen dhe zhvillohen si studime të rregullta. Në të gjitha programet, mësimi kryesisht realizohet në formë ligjëratave, ushtrimeve / mësimit laboratorike, punës praktike, rasteve të studimit, seminareve, mobiliteteve, diskutimeve, konsultime profesionale dhe nëpërmes punimeve të pavarura të studentëve.

Në lëndë të cilat kërkohet shkathtësi kreative, artistike si dhe profesionale mësimi do të organizohet në formë të studentit në qendër si psh. pjesëmarrje aktive e studentit gjatë tërë procesit mësimor, eksplorimi i kreativitetit individual në funksion të të nxërit të tij/saj, interaktivitet, me vlerësim të vazhdueshëm ku merren parasysh edhe aktivitetit gjatë semestrit, mënyra e diskutimeve gjatë procesit mësimor etj.

Neni 5

Viti akademik fillon me 1 Tetor dhe zgjatë deri me 30 Shtator të vitit të ardhshëm,

Mësimi në studimet master zhvillohet në 15 javë.

Numri i tërësishëm i lëndëve zgjedhore të cilat u ofrohen studentëve për t'i zgjedhur nuk mund të jetë më i madh se dyfishi i lëndëve zgjedhore që duhet të zgjidhen.

Ngarkesa vjetore e studentit me ligjërata, ushtrime, përgatitje dhe të tjera është 750 orë në semestër, respektivisht 1500 orë në vit, që korrespondon me 30 kredi në semestër apo 60 kredi në vit. Çdo ECTS kredi është e barabart me 25 orë angazhim të studentit.

Studimet master zgjasin 2 vite (4 semestra) ku duhet të arrihen 120 ECTS kredi.

Neni 6

Studimet master zhvillohen sipas sistemit semestral dhe bazohen kryesisht në lëndët e ngushta të specializimit brenda programeve të Akademisë. Sistemi i punës në këto studime do të përfshijë edhe orët e punës praktike përkatësisht praktikën kërkimore hulumtuese të cilën duhet ta përfundojnë studentët.

Komitetet e programeve në Akademi vendosin se në cilat lëndë hyrja në provim ka parakusht lidhur me dhënien e një ose më shumë lëndëve paraprake.

Vlerësimi dhe notimi bëhet nga mësuesi i lëndës brenda 10 ditëve nga provimi përfundimtar. Të gjitha detyrat dhe provimet ruhen në arkiv për një vit.

IV. Kushtet e regjistrimit në studime master

Neni 7

Kandidatët mund të regjistrohen në programet e studimit të cilat i ofron Akademia.

Regjistrimi i studentëve në programet e studimit bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara nga MASHT-i dhe Këshilli Akademik si dhe konkursit publik të shpallur nga Këshilli Drejtues i Akademisë.

Neni 8

Nuk do të ketë kufizime moshe për t'u regjistruar apo të marrë kualifikim të arsimit të lartë.

Neni 9

Të gjithë kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor dhe kanë grumbulluar së paku 180 ECTS kredi, gëzojnë të drejtën për të aplikuar në studime master në Akademi.

Neni 10

Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur në konkurs bëhet sipas kritereve të vendosura nga Këshilli Akademik për çdo vit.

Në rastet kur Akademia bënë pranimin e kandidatëve përmes provimit pranues, kandidati ka të drejtë të paraqesë ankesë te Koordinatorin e programit dhe këtë të drejtë mund ta ushtroj në afatin prej 48 orë nga dita e shpalljes së rezultateve. Brenda këtij afati kandidati ka të drejtë të shoh punën e tij (në rastet kur ka provim pranues).

Kundër listës së rangimit, kandidati ka të drejtë të paraqesë ankesë te Koordinatori i programit dhe këtë të drejtë mund ta ushtroj në afatin prej 48 orë nga dita e shpalljes së rezultateve.

Neni 11

Përzgjedhja e kandidatëve, do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Akademik.

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë, jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të lëndëve prioritare, e nëse edhe pikët e lëndëve prioritare janë të njëjta, atëherë do të mirret parasysh sukcesi i studimeve themelore Bachelor. Nëse edhe sukcesi është i njëjtë, përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femrore. Në qoftëse kandidatët i takojnë gjinisë së njëjtë, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Këshillit Akademik në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta.

Neni 12

Dokumentet e nevojshme për të konkurruar në studimet master janë:

- Fletëregjistrimi me dy fotografi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Diploma origjinale e kryerjes së studimeve bachelor
- Certifikata e notave të studimeve bachelor (origjinale ose e noterizuar)
- Certifikata e lindjes

Në rast se studenti ka mbaruar studimet bachelor jashtë vendit, duhet të kenë të nostrifikuar diplomën e së studimeve bachelor sipas kërkesave të MASHT.

Dokumentet që i paraqet studenti me rastin e regjistrimit mbeten në shërbimin e administratës së Akademisë deri në përfundimin e studimeve apo edhe në rast të ndërprerjes së studimeve.

Shërbimi i administratës e bënë regjistrimin e studentëve të rijnë në librin amzë dhe në sistemin elektronik për menaxhimin e studentëve dhe formon dosjen e studentëve me numër rendor përkatës varësishtë nga viti akademik i regjistrimit.

Neni 13

Studenti duhet të ketë kompletuar procedurën për regjistrim, që përfshin:

- Aplikim online;
- Dorëzim të dokumenteve sipas konkursit;
- Përmbushje e të gjitha kushteve për regjistrim;
- Dëshminë e pagesës për studime master;

Kushtet dhe kriteret tjera për pranim dhe regjistrim në vitin përkatës përcaktohen me vendim të veçantë.

Regjistrimin e studentëve në semestrin e parë në bazë të konkursit e bënë administrata e Akademisë, të dhënat menaxhohen nga Akademia, duke u respektuar ligji i privatësisë dhe duke u dhënë studentëve udhëzuesit për punën dhe funksionimin e këtij programi.

V. Kushtet e regjistrimit të vitit në studime master

Neni 14

Kriteret e kalueshmërisë së studentëve nga viti në vit përcaktohen nga Këshilli Akademik për çdo vit akademik.

Studentët të cilët i plotësojnë kriteret për regjistrimin e vitit Akademik, në momentin e regjistrimit duhet t'i përmbushin të gjitha obligimet financiare ndaj Akademisë.

Neni 15

Studenti i cili nuk ka mundur ta përfundojë me sukses vitin duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve.

Numri maksimal i viteve të regjistruar sërish është i barabartë me numrin e viteve të rregullta të studimit përkatës.

Neni 16

Studenti duhet t'i përfundon studimet në Akademi brenda një periudhe që nuk tejkalon dyfishin e periudhës normale të paraparë për studimet të cilat i ka regjistruar, me përjashtim të rasteve të veçanta për të cilat vendosë Këshilli Akademik.

VI. Statusi i studentit

Neni 17

Statusin e studentit një person (individ) e fiton me rastin e regjistrimit në programet e studimeve të cilat i ofron Akademia, dhe i plotëson detyrimet e veta akademike dhe financiare në pajtim me ligjimin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe aktet tjera të përgjithshme të Akademisë.

Studenti, Statusin e vet e dëshmon me kartelën e studentit, e cila posedon numrin identifikues sipas regjistrimit në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve SEMS.

Formën dhe përmbajtjen e dokumentit nga pika 2 e këtij neni e përcakton Akademia në përputhje me legjislacionin e MASHTI.

Neni 18

Nëse studenti e humbë kartelën, administrata (shërbimi i studentëve) në bazë të shënimeve zyrtare dhe me njoftim të Koordinatorit të programit, ia jep kartelën dublikate e që i përgjigjet dokumentit të humbur.

Studenti së bashku me kërkesë i bashkëngjit edhe fletë dëshminë se dokumenti është shpallur i pavlefshëm, dhe dëftesën mbi pagimin e shpenzimeve për lëshimin e kartelës dublikate.

Studenti që i ka përmbush të gjitha detyrimet e parapara me planin dhe programin mësimor në pajtim me Statutin e Akademisë, fiton të drejtën për t'u regjistruar në vitin pasues të studimeve.

Neni 19

Studenti e humb statusin e studentit në këto raste:

- Kur ndërpret studimet;
- Kur i ka përfunduar studimet;
- Kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishitë të kohëzgjatjes së studimeve;
- Me vendim të Akademisë mbi procedurën disiplinore, si dhe raste tjera që parashihen me ligj, statut dhe aktet të tjera normative.

Neni 20

Studenti mund të kërkojë t'i pezulloj studimet dhe përgjegjësitë që dalin me statusin e studentit të rregullt në rastet e dëshmuar si:

- Sëmundjes së rëndë;
- Kujdesi për fëmijën nën moshën tre vjeçare;
- Shtatzënisë lehonisë së studentes, si dhe
- Rastet të tjera të parapara me ligj dhe statut të Akademisë.

VII. Të drejtat dhe detyrimet e studenteve

Neni 21

Studentët kanë këto të drejta:

- Të marrin pjesë në ligjërata, seminare, ushtrime teorike, ushtrime praktike laboratorike dhe në teren, mobilitete, hulumtime, diskutime, konsultime profesionale dhe format tjera të mësimit sipas plan-programit në fuqi;
- Të shfrytëzojnë bibliotekën e Akademisë, hapësirën fizike dhe pajisjet tjera teknike si internetin, laboratorët, kompjuterët etj.

- Të marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit e studentëve në organet përfaqësuese të Akademisë dhe të studentëve, si dhe të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e besuara në organet e Akademisë;
- Të marrin pjesë në aktivitetet kulturore e sportive, seminare profesionale, konferenca dhe tubime të studentëve;
- Të marrin pjesë në konkurs për çmimin student i dalluar dhe bursist i Akademisë si dhe të drejta të ndërlidhura me to, që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen aktive dhe kritike të studentit.

Neni 22

Studentët kanë këto obligime:

- Ti zbatojnë rregullat e përcaktuara nga Akademia;
- Të respektojnë të drejtat e personelit dhe studentëve të tjerë;
- Të kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
- Të vijojnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programeve specifike të studimeve;
- Të tregojnë kulturë njerëzore dhe akademike në ambientet e Akademisë ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskredituar Akademinë.

VIII. Afatet, paraqitja dhe mbajtja e provimeve

Neni 23

Provimet për studime master mbahen gjatë afatit të provimeve;

- Afatet e rregullta të provimeve për student janë: Janar-Shkurt, Qershor dhe Shtator;
- Këshilli Akademik në mund të vendosë edhe për organizimin e afateve jo të rregullta të provimeve.
- Oraret e afateve të provimeve për studentë shpallen në fillim të vitit akademik.

Neni 24

Koha e paraqitjes së provimeve dhe orari i provimeve do të fillojë jo më vonë se 8 ditë para fillimit të mbajtjes së provimeve.

Neni 25

Nëse studentët nuk mund të hyn në provim për shkak të një arsye madhore, konsiderohet që provimi është anuluar dhe zhvendosur për një kohë të caktuar.

Në të gjitha rastet kur studentit mungon ose tërhiqet nga provimi, atëherë konsiderohet që studentit ka dështuar.

Me leje të Koordinatorit të programit studenti mund të t'i nënshtrohet provimit në një orar tjetër të përshtatshëm për studentin me qëllim që t'i mundësohet pjesëmarrja në ndonjë program ndërkombëtar për shkëmbim të studimeve, ose për të bërë mësim praktik jashtë vendit gjatë periudhës së caktuar për provim.

Neni 26

Provimet mbahen me shkrim, me gojë, prezantim të punimeve seminarike por edhe ushtrime/ mësim laboratorike praktike, vlerësim i vazhdueshëm dhe mjete tjera përcjellëse si dhe në distancë përmes platformave të përcaktuara nga Akademia.

Provimet të cilat përbëhen prej pjesës me gojë dhe me shkrim, studenti mund të hyjë në provim me gojë vetëm atëherë kur të kalon pjesën e provimit me shkrim.

Për lëndët specifike të cilat kërkojnë shkathësi kreative, artistike si dhe profesionale përdoret vlerësim i vazhdueshëm.

Suksesi i studentit në provim shprehet me nota prej 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë).

NOTA	ECTS NOTA	PIKËT	PËRKUFIZIMI
10	A	90-100	SHKËLQYESHËM/EXCELLENT
9	B	80-89	SHUMË MIRË/VERY GOOD
8	C	70-79	MIRË/GOOD
7	D	60-69	KËNAQSHËM/SATISFACTORY
6	E	50-59	MJAFTON/SUFFICIENT
5	F	0-49	DOBËT/ POOR

Nota shënohet me numër dhe tekst në fletëparaqitje, procesverbal dhe SEMS.

Fletëparaqitja bashkë me procesverbalin e mbajtjes së provimit përkatës i dorëzohen administratës për të bartur në librat amë.

Mësimdhënësi është i obliguar që të shpallë rezultatet (vendos notat në SEMS) brenda 10 ditëve nga data e mbajtjes së provimit.

Neni 27

Studenti ka të drejtë t'i parashtrijë ankesë me shkrim te koordinatori i programit kundër vlerësimit të bërë nga mësimdhënësi për provimin përkatës;

Koordinatori i programit në afatin prej 24 orësh emëron komisionin prej tre anëtarë por pa pyetësin.

Njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë i lëmisë së ngushtë me lëndën për të cilën vlerësohet studenti.

Koordinatori i programit e cakton kohën e mbajtjes së provimit në afatin prej tri ditësh nga dita e paraqitjes së ankesës së studentit – kandidatit.

Provimi me shkrim ose pjesa me shkrim e provimit mund të përsëritet para komisionit, apo të rivlerësohet nga testi i njëjtë.

Studenti nuk mund të parashtrijë ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

Neni 28

Studenti ka të drejtë të hyjë në provim më së shumti tri here në të njëjtin provimin që nuk e ka përfunduar me sukses;

Studenti me një arsyetim të ligjshëm mund t'i lejohet nga Koordinatori i programit që edhe herën e katër të hyjë në provim, pranë komisionit përkatës.

Në rast se studentit regjistrohet po në të njëjtin vit të studimeve, nuk merret parasysh numri i më parëshëm i provimeve të dështuara të studentit.

Në rast se serish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai e humb statusin e studentit të rregullt për këtë lloj të studimeve.

IX. Përfundimi i studimeve dhe punimi i diplomës

Neni 29

Studimet master përfundojnë me mbrojtjen e punimit të diplomës, në përputhje me programin studimit.

Studenti i cili ka kryer obligimet e parapara me programin e studimit, ka të regjistruar të katër semestrat, ka kryer të gjitha obligimet ndaj Akademisë dhe ka më së shumti një provim të pa dhënë, fiton të drejtën për marrje të punimit të masterit.

Studenti së bashku me mësimdhënësin e lëndës mund të propozojnë titullin e temës së diplomës nga lëmia përkatëse në harmoni me nevojat e ndërmarrjeve ose institucioneve hulumtuese dhe të tjera në marrëveshje.

Punimi për master elaborohet individualisht nga studentit duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve konkrete kërkimore në fushën shkencore/ profesionale për të cilën është përcaktuar studentit.

Punimi i diplomës për master mund të elaborohet bashke me dy ose tre studentë (grup kërkimor) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.

Aplikimi për elaborimin e punimit të diplomës për master nga dy ose tre kandidatë përcaktohet nga Këshilli Akademik.

Kandidati që ka fituar të drejtën për të paraqitur punimin e masterit, dorëzon projektpropozimin për temën e punimit të diplomës.

Neni 30

Forma e rregullimit të temës së diplomës master është e rregulluar sipas Manualit për përgatitjen e temës së diplomës i aprovuar nga Këshilli Akademik.

Neni 31

Këshilli Akademik, themelon Komisionin e studimeve i cili përbëhet nga 3 anëtarë.

Komisioni në takimin e parë bënë zgjedhjen e kryetarit të këtij komisioni. Komisioni takohet në bazë të kërkesave të studentëve për të lejuar temën e masterit.

Neni 32

Detyrat e komisionit për studime master janë:

- Shqyrtimin dhe aprovimin/refuzimin e propozimit të temave të studimeve master të propozuara nga mësime të mësimdhënës.
- Propozon Këshillit Akademik mentorin për udhëheqje të temës së propozuar
- Propozon Këshillit Akademik anëtarët e komisionit vlerësues për shqyrtimin e propozimit, vlerësimin dhe mbrojtjes publike të punimit të temave të diplomës master.

Punimi i masterit paraqet punën e pavarur shkencore/ profesionale të kandidatit me të cilën ai tregon që ka përvetësuar njohuri për të zgjedhur probleme dhe detyra shkencore e profesionale.

Neni 33

Kandidati është i detyruar që të dorëzojë punimin final të temës së masterit në zyrën e shërbimit të studentëve në afat kohor prej më së shumti një viti, prej ditës kur i është lejuar punimi i masterit.

Me kërkesë të kandidatit, Këshilli Akademik mund të caktoj afat të ri më së shumti deri në 6 muaj për të dorëzuar punimin e masterit. Shtyerja e afatit bëhet me një arsye të fortë siç është sëmundja apo raste të tjera të cilat i përcakton Këshilli Akademik.

Kur kandidati e dorëzon punimin e masterit, për vlerësim, Këshilli Akademik, me propozim të Komisionit për studime, formon Komisionin për vlerësimin e temës së masterit. Komisioni vlerësues përbëhet prej tre anëtarëve të rregullt dhe një rezervë.

Komisioni për vlerësim është i obliguar që në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit, ta shkruaj raportin e vlerësimit të përshtatshëm, ta protokollojë në arkivin e Akademisë dhe ta paraqes në Këshillin Akademik.

Raportin duhet të jenë i nënshkruar nga shumica e anëtarëve të Komisionit vlerësues, Komisioni vlerësues mund të propozoj që punimi të miratohet dhe kandidatit ti lejohet mbrojtja, të plotësohet apo të refuzohet.

Anëtari i Komisionit vlerësues i cili nuk e përkrahë raportin, detyrohet që mendimin e vet ta ndaj dhe ta paraqet në formë të shkruar.

Në qoftë se Këshilli Akademik ia kthen kandidatit punimin për ta plotësuar, në atë rast mund të plotësohet Komisioni për vlerësimin e punimit. Kandidati duhet të bëjë plotësimin e punimit të masterit në afat prej më së largu 6 muaj. Kur Komisioni vlerësues pranon punimin e plotësuar, është i obliguar që të hartoj raport të ri mbi vlerësimin e punimit dhe të njëjtin ia dërgon Këshillit Akademik në afat prej 15 ditësh, prej ditës kur e ka pranuar punimin. Raportin duhet ta përkrahin shumica e anëtarëve të Komisionit vlerësues.

Neni 32

Në qoftë se punimi i kandidatit refuzohet ose kandidati për shkaqe të tjera nuk e bënë plotësimin e punimit në afatin sipas nenit paraprak, kandidati ka të drejtë që të paraqet propozimin për titull të ri të punimi të masterit. Këtë mundësi kandidati mund ta shfrytëzoj vetëm një herë.

Neni 35

Shumica e anëtarëve të komisionit duhet të jenë nga fusha shkencore nga e cila është punuar punimi i masterit.

Neni 36

Në bazë të propozimit të Komisionit për vlerësim së temës së masterit, Këshilli Akademik nxjerr vendim për miratim të raportit dhe cakton afatin e diskutimit publik i cili nuk mund të jetë më i shkurtë se 5 ditë.

Nëse pas diskutimit publik nuk ka pasur komente/ankesë, Kryetari i Komisionit vlerësues në koordinim me anëtarët tjerë dhe kandidatin, cakton terminin për mbrojtjen publike të temës së masterit.

Në rastet kur gjatë diskutimit publik ka vërejtje, ato duhet të bëhen me shkrim, të dihet autori i tyre dhe ti drejtohen Këshillit Akademik. Këshilli Akademik në mbedhjen e rradhës i shqyrton komentet/ankesën e parashtruar dhe merr vendim për pranimin apo hedhjen poshtë të saj. Në rastet kur ndonjëri nga anëtarët e Komisionit vlerësues nuk mund të merr pjesë në mbrojtjen publike të temës së masterit, ai/ajo zëvendësohet me anëtarin rezervë.

Neni 37

Me rastin e dorëzimit të punimit kandidati duhet të dorëzoj edhe shënimet biografike.

Tema dorëzohet në 6 kopje identike (lidhje e fortë).

Lajmërimi i datës së mbrojtjes publikohet në tabelen e shpalljeve dhe web faqen e Akademisë.

Nëse kandidati nuk e mbron punimin e masterit për shkaqe të pa arsyeshme në afatin nga neni paraprak, Këshilli, në propozim të komisionit para të cilit është dashtë të kryhet mbrojtja e punimit, me vendim ndërprejë procedurën për fitim të thirrjes akademike të masterit dhe kandidatit i kthehet punimi i masterit.

X. Plagjiatura dhe e drejta intelektuale

Neni 38

Akademia është pronar i temës së masterit, punës studimore që është bërë në të, rezultateve të studimit dhe potencialisht i çdo përfitimi që mund të del nga rezultatet e punimi të masterit të studentit.

Studenti është përgjegjës për përmbajtjen e punimit të diplomës së masterit. Akademia, përmes platformave anti-plagjiaturë, gëzon të drejtën e vlerësimit të përmbajtjes së punimit të diplomës. Në një punim të masterit duhet që së paku të 70% e punës së studentit të jetë e tij/saj.

Në mungesë të një sistemi të tillë, student i obligohet që në punimin e tij/saj të vendosë një deklaratë përmes së cilës student i konfirmon që tema është punë vetanake dhe se nuk është e huazuar. Në momentin aplikimit të softuerit anti-plagiature, Akademia e gëzon të drejtën e testimit të temave të diplomës së masterit të fituara pas aprovimit të kësaj rregulloreje. Në rast të shkeljes së dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, Akademia e dërgon studentin në Këshill të Etikës.

XI. Procedura e mbrojtjes së temës së masterit

Neni 39

Kryetari i Komisionit vlerësues e hap mbrojtjen publike të punimit të masterit, paraqet të dhënat lidhur me procedurën e zhvilluar deri në nxjerrjen e vendimit mbi lejimin e mbrojtjes së punimit të diplomës si dhe paraqet të dhënat biografike dhe të tjera të kandidatit.

Kandidati bënë prezantimin e punimit, por jo më gjatë se 30 minuta.

Pastaj kandidati u përgjigjet pyetjeve të komisionit dhe auditoriumit.

Kur komisioni konstaton se punimi i masterit është shqyrtuar në masë të mjaftueshme, kryetari bënë përfundimin e mbrojtjes dhe fton komisionin për vlerësim të temës së mbrojtur.

Vendimi shpallet publikisht.

Neni 40

Kandidati ka mbrojtur punimin e masterit nëse komisioni vlerësues e vlerëson me notë nga 6 deri në 10.

Kandidati konsiderohet se ka mbrojtur punim me sukses nëse vlerësohet deri në 80 pikë, ndërsa nëse vlerësohet mbi 80 pikë konsiderohet se ka mbrojtur punimin me sukses të dalluar.

Neni 41

Me përfundimin e suksesshëm të studimeve master kandidati fiton thirrjen master shkencor / profesional (MSc) varësisht prej fushës studimore të kryer.

Neni 42

Nëse kandidati nuk mbron me sukses punimin e masterit, mund të paraqesë propozim të ri brenda 6 muajve prej ditës së njohimit se punimin nuk e ka mbrojtur me sukses.

Neni 43

Pas arritjes së thirrjes master në fushën përkatëse, kandidatit i lëshohet certifikata e diplomës si dhe diploma nga Akademia.

Neni 44

Nëse pas punimit të masterit konstatohet se punimi nuk është i pavarur, kandidatit mund t'i hiqet titulli i fituar nga Këshilli Akademik me rekomandim të Drejtorit.

Neni 45

Në rastin e mëparmë nga neni paraprak, Këshilli emëron komision prej 3 anëtarëve që të shqyrtoj dyshimet e paraqitura lidhur me punimin e masterit.

XII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 46

Për çështjet të cilat nuk janë përfshirë me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës dhe Statutit të Akademisë.

Neni 47

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen me procedurë të njëjtë me atë të miratimit të saj.

Neni 48

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja me nr.003/20 për studime e aprovuar më 04.12.2020

Neni 49

Rregullorja hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Akademik.

Kryesuesi i Këshillit Akademik

Dr.Sc.Mevlan Bixhaku

